



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E LIPJANIT  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pran më: Priljeno: 15.05.2018		
Njësia Jurmica	Lipjan Qendër	Shërbimi Qendror
1-660-30718		



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

*Lipjan, 15.05.2018*

**THIRRJE PUBLIKE** për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve ( **KLUBET SPORTIVE** ) të regjistruara dhe të cilat bëjnë gara zyrtare në Federatat përkatëse.

1. Komuna e Lipjanit u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, (**KLUBET SPORTIVE** ) që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në *avancimin dhe afirmimin e SPORTIT në Komunën e Lipjani*.
2. OJQ-të (**KLUBET SPORTIVE**) në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte në lëmin e sportit dhe sipas fushave mbështetëse si në vijim:
  - a) Mbështetje financiare për mbulim të shpenzimeve të referimit për ndeshjet zyrtare
  - b) Mbështetje financiare për mbulim të shpenzimeve të transportit për ndeshje zyrtare
  - c) Mbështetje financiare për mbulim të shpenzimeve të ushqimit për ndeshje zyrtare
  - d) Mbështetje financiare për mbulim të shpenzimeve të regjistrimit dhe kotizimit në Federatat përkatëse
  - e) Mbështetje financiare për mbulim të shpenzimeve për blerje të rekuizitave sportive
3. Organizatat jo-qeveritare (**KLUBET SPORTIVE** ) mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e sportit në Komunën e Lipjanit.

4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 04.06.2018.

5. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 6 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të (KLUBET SPORTIVE) që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike. Klubet aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e sportit. KLUBET SPORTIVE duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

6. Para nënshkrimit të kontratës, KLUBI duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në KLUB dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se KLUBI ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

**KOMUNA E LIPJANIT**

**Rruga „Shqipëria“**

**Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,**


Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [agim.bylykbashi@hotmail.com](mailto:agim.bylykbashi@hotmail.com), ose nr kontaktues 044/883-921, orari 08:00h -16:00h.

Kryetari i Komunës së Lipjanit

z. Imri AHMETI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Imri Ahmeti', written over a horizontal line.